

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 716 / Prot.
2

Tiranë, më 04/02/2021

URDHËR

Nr. 52, Datë 04.02.2021

**“PËR
HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT, NOTERIT
ALVI PREVAZI”**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 6, të nenit 7 pikës 2 të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 21, pika 1, shkronja “ë”, dhe nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”,

KONSTATOJ:

Bazuar në Urdhrin nr. 2510 datë 04.04.2016 të Ministrit të Drejtësisë “Për dhënien e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit dhe përcaktimin e njesisë vendore të ushtrimit të veprimtarisë noteriale, noteri Alvi Prevazi ka fituar të drejtën ushtrimi të profesionit të noterit.

Në zbatim të Urdhër nr. 181, datë 15.06.2020 “Për miratimin e programit vjetor të inspektimit të Noterëve për vitin 2020”, me Urdhër nr. 395 datë 24.11.2020 u përcaktua inspektimi i përgjithshëm i noterit Alvi Prevazi. Në datë 25.11.2020, grupi i inspektimit u paraqit në adresën zyrtare “*Rruga Egnatia, Lgji. 4, Pll. 146, Durrës*” (referuar të dhënave në QKB), për realizimin e detyrave përkatëse, nga ku rezultoi se zyra ishte e mbyllur dhe tabela jashtë zyrës, relatonte vetëm të dhënat e noteres Miriana Prevazi.

Pas komunikimeve me Noterin Alvi Prevazi nëpërmjet rrjetit whats-up, informacioni që u komunikua nga ky i fundit ishte se “*Ndodhej jashtë shtetit për arsye familjare dhe se në shkurt të vitit 2019, kishte paraqitur kërkesë për pezullim të aktivitetit në Dhomën Vendore të Noterëve, Durrës, dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë*”. Për verifikimin e pretendimeve të paraqitura nga noteri Alvi Prevazi, në vijim të njoftimit me shkresën nr. 7350/1 prot., datë 24.11.2020, mbi Urdhërin nr. 395, dt. 24.11.2020 të Ministrit të Drejtësisë “Për inspektimin e përgjithshëm të noterit Alvi Prevazi” (drejtuar Dhomës Kombëtare të Noterisë, Degës Vendore Durrës dhe për dijeni noterit Alvi Prevazi), nga struktura përgjegjëse u realizuan veprimet për sa vijon:

Me shkresë nr. 7350/2 prot., dat. 27.11.2020, drejtuar Dhomës Kombëtare të Noterisë, Degës Vendore Durrës u kërkua informacion zyrtar mbi kërkesën e paraqitur për pezullimin e aktivitetit nga noteri Alvi Prevazi (sipas pretendimeve të paraqitura prej tij)

Në datë 28.11.2020, nga Znj. Mimoza Sadushi, Kryetare e Dhomës Kombëtare të Noterisë është kthyer përgjigje në rrugë elektronike (email), duke bashkëlidhur kërkesën (të skanuar me aktet

bashkëlidhur) e noterit Alvi Prevazi datë 06.02.2020, për pezullimin e aktivitetit me një afat 2 vjeçar, për arsye: *“Të përkujdesjes ndaj dy fëmijëve në kushtet kur bashkëshortja e tij, Stela Shehu ishte e punësuar me orare të zgjatura në Universitetin e Torinos, Itali”*.

Evidentohet se kjo kërkesë i është drejtuar vetëm Dhomës Kombëtare të Noterisë, Znj. Mimoza Sadushi dhe jo Ministrisë të Drejtësisë, sikundër parashikohet në nenin 18 të Ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”.

Pas konstatimit nga grupi i inspektimit të faktit se nga ana e noterit nuk ushtrohej veprimtaria noteriale nga muaji shtator 2019, pa miratimin e Ministrisë të Drejtësisë, noteri Alvi Prevazi ka paraqitur kërkesë për pezullim më datë 30.11.2020 në rrugë elektronike (email) në adresë të Znj. Aida Shehi, si dhe në datë 07.12.2020, është paraqitur kërkesë/shkresë në rrugë elektronike (email zyrtar), në adresë të Z. Gentian Deva, Sekretar i Përgjithshëm, dhe Znj. Aida Shehi, Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, me objekt “Kërkesë për heqje dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit, Drejtuar Ministrisë të Drejtësisë”. Kërkesa është paraqitur në rrugë postare regjistruar pranë nesh me nr.A-399/1, datë 11.12.2020.

Vlen të theksohet fakti se, kërkesa për pezullim drejtuar Ministrisë të Drejtësisë (datë 30.11.2020, dërguar në format word), si dhe kërkesa për heqje dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit (datë 07.12.2020, dërguar me email, si dhe zyrtarisht më datë 11.12.2020) nga noteri Alvi Prevazi, janë paraqitur vetëm pas kontaktimit nga grupi i inspektimit ngritur me Urdhërin nr. 395, dt. 24.11.2020 të Ministrisë të Drejtësisë “Për inspektimin e përgjithshëm të noterit Alvi Prevazi”, mbi mos ushtrimin e veprimtarisë.

Referuar rrjedhës kronologjike të fakteve paraqitur nga noteri Alvi Prevazi, si dhe parashikimeve ligjore të nenit 63 ku përcaktohen “Detyrat e Noterit”, detyrimi për mbajtjen e zyrës hapur, dispozitë e aplikuar për rastin në fjalë, në harmoni me parashikimet e nenit 18 mbi kërkesën për “Pezullimin e përkohshëm i licencës së noterit me kërkesën e tij”, ashtu dhe parashikimeve të pikës 1/a të nenit 21, për rastet e Heqjes së licencës me kërkesën të tij, konkludojmë se pavarësisht të gjitha instrumentave ligjore që ka patur ky subjekt, me neglizhencë apo vetëveprim ka sjellë si pasojë, braktisjen e detyrës në mënyrë të përsëritur. Nga verifikimi në RNSH rezulton se noteri gjatë viteve 2017-2020, në mënyrë të përsëritur nuk ka ushtruar veprimtari noteriale, konkretisht:

- për vitin 2017 nuk ka kryer veprime nga muaji tetor deri në muajin dhjetor.
- për vitin 2018, ka kryer veprime vetëm në muajin qershor, korrik dhe gusht 2018, ndërkohë nuk ka ofruar shërbim për 9 muaj.
- Për vitin 2019, ka kryer veprime vetëm në muajin gusht 2019, ndërkohë nuk ka ofruar shërbim për 11 muaj.

Referuar fakteve dhe rrethanave si më lartë përmendur, vlerësojmë se Noteri Alvi Prevazi është në shkelje të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, konkretisht sipas parashikimeve në shkronjën ë), pika 1 e nenit 21, ku sanksionohet se:

1. *Heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit bëhet me urdhër të ministrit të Drejtësisë, kur noteri:*

...

ë) *nuk ushtron veprimtarinë noteriale për një periudhë kohe deri në 60 ditë rresht pa shkak të arsyeshem, të dokumentuar dhe të njoftuar me shkrim pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Ministrisë të Drejtësisë;*

Gjithashtu, me shkresën nr. 7350 prot., datë 18.01.2021, i është përcjellë për njohje noterit Alvi Prevazi dhe për dijeni Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Dhomës Vendore të Noterisë Durrës,

raporti i hartuar nga grupi i kontrollit së bashku me konkluzionet, duke i lënë 10 ditë kohë për të përcjellë kundërshtimet edhe argumentet mbi raportin.

Noteri Alvi Prevazi është paraqitur personalisht në Ministrinë e Drejtësisë në datë 01.02.2021 (në kapërcim të afatit 10 ditor, duke mos paraqitur observacione shkresore sa i përket raportit), duke dorëzuar kërkesë shkresore mbi dorëzimin e vulave (të thatë dhe të njomë) dhe deklaratë noteriale sa i përket arshivës dhe regjistrave noteriale, protokolluar pranë nesh me nr. A-399 /4 prot., dt. 01.02.2021, për arsye të pandemisë dhe faktit që është kthyer në Republikën e Shqipërisë vetëm për dy ditë, duke qenë se jeton në Itali.

Me Proçes – Verbal “Për asgjësimin e vulës së noterit Alvi Prevazi”, protokolluar me nr. A-399/5 prot., dt. 01.02.2021, në Ministrinë e Drejtësisë u realizua dorëzimi dhe asgjësimi i vulave në prani të noterit Alvi Prevazi.

Për sa më sipër, referuar pikës 1, gërmës “e” të nenit 21, të ligjit 110/2018 “Për Noterinë”, ku parashikohet se: *“Heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit bëhet me urdhër të Ministrisë së Drejtësisë, kur noteri... nuk ushtron veprimtarinë noteriale për një periudhë kohe deri në 60 ditë rresht pa shkak të arsyeshëm, të dokumentuar dhe të njoftuar me shkrim pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Ministrinë e Drejtësisë”, për këtë arsye:*

URDHËROJ:

1. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të Noterit Alvi Prevazi, anëtar i Degës Vendore të Noterisë Durrës, për shkak të mos ushtrimit të veprimtarisë noteriale për një periudhë kohe deri në 60 ditë rresht pa shkak të arsyeshëm, të dokumentuar dhe të njoftuar me shkrim pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Ministrinë e Drejtësisë.

2. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
a) Znj. Ina Papa, Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira pranë Ministrisë së Drejtësisë;
b) Z. Alfred Pupli, Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira pranë Ministrisë së Drejtësisë;
c) Znj. Aida Spahiu, përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Noterisë.
d) Znj. Majlinda Lama, përfaqësuese e Dhomës Vendore të Noterisë Durrës.

3. Administrimin në dosje të Proçes – Verbal “Për asgjësimin e vulës së noterit Alvi Prevazi”, protokolluar me nr. A-399/5 prot., dt. 01.02.2021, në Ministrinë e Drejtësisë.

4. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Gjykatat e Shkallës së Parë dhe Apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noteriale, si dhe të evidentojë çdo mungesë, dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.

6. Arkivi noterial të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Durrës dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë.

7. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit, merr masa për dorëzimin me procesverbal të arkivës noterit Miriana Prevazi, anëtare e Dhomës Vendore të Noterisë Durrës, propozuar nga Dhoma Vendore Durrës, brenda 5 ditëve pune nga mbarimi i afatit të ankimit të urdhërit.

8. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.

9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
ETILDA GJONAJ (SALIU)

